



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 815, Datë 02.09.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 803, DATË 28.05.2021 “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË VAJIT VEGJETAL”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.09.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin nr. 803, datë 28.05.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 42 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm për një ndryshim në vendimin nr. 803, datë 28.05.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121/2003, me vendimin nr. 803, datë 28.05.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, vendosi:
 - i. Hapjen e procedurës së hetimit të paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal.
 - ii. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 tetor 2020 deri në 20 maj 2021.
 - iii. Raporti i hetimit duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 4 (katër) muaj nga marrja e vendimit.

2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak, për vlerësimin e konkurrencës në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, është kërkuar informacion nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
3. Lidhur me kërkesën për informacion drejtuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 245/6 prot., datë 11.06.2021 dhe nr. 245/9 prot., datë 01.07.2021, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i është përgjigjur kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës me shkresën nr. 4987/1 prot., datë 12.07.2021 (protokolluar pranë AK me nr. 245/10 prot., datë 13.07.2021), duke e bërë të pamjaftueshme kohën e mbetur në dispozicion për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, si dhe duke e bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 803, datë 28.05.2021.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 803, datë 28.05.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, pika 3 e tij të ndryshohet si vijon:
Raporti i hetimit duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 4 (katër) muaj nga marrja e vendimit.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS